Nr. prot. 5596
Dt. 02.9.2026

NENKRYETARI
VIJONI SIPAS LIGJ.
PROTOKOLLI
Dt. 02-09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
DREJTORIA E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR NJOHJE PRONËSIE

Nr. 5445/1 prot.

Tiranë, më 31.08.2026

Lënda: **Kërkesë e përsëritur për afishimin e shpalljes**

**BASHKISË KOLONJË**

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Proçedurave Administrative, ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 "*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit*", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 222, datë 23.03.2016 "*Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës*" e ndryshuar, pika 6 e saj, ku është parashikuar se "*Kur ATP-ja konstaton mangësi në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, njofton kërkuesin me postë të porositur që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të plotësojë pasaktësitë. Kur kërkuesi nuk ka marrë dijeni për mangësitë në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, ATP-ja kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vendbanimin e kërkuesit, me qëllim kryerjen e njoftimit përmes postës së porositur*". *Kur njoftimi nuk është i mundur ose vendbanimi i kërkuesit nuk është i njohur, njoftimi bëhet me shpallje në selinë e ATP-së, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi, si dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin. Njoftimi vlerësohet i kryer pas 10 (dhjetë) ditëve nga data e shpalljes, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative,* kërkojmë nga ana juaj që shpalljen bashkëlidhur kësaj shkrese për njoftimin e subjektit për pjesëmarrje në procedimin administrativ ta afishoni në "Këndin e Njoftimeve".

**Ju lutemi të na konfirmoni datën e shpalljes nga ana juaj me shkresë drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave në adresën zyrtare!**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Valdrin PJETRI**

Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 54, Tiranë, www.atp.gov.al, info@atp.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

DREJTORIA E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR NJOHJE PRONËSIE

Nr. 5495 prot. Tiranë, më 31.08.2026

# SHPALLJE

## PËR
## NJOFTIMIN E SUBJEKTIT PËR PJESËMARRJE NË PROCEDIM ADMINISTRATIV PËR BASHKINË KOLONJË

Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave Tiranë (ATP), janë duke u shqyrtuar dosjet dhe kërkesë/praktikat me të dhëna si më poshtë:

| Nr. Rend. | Nr. Dosjes | Data | Qarku | Emri subjektit të shponësuar | Mbiemri | Emri Subjektit kërkues | Mbiemri |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3544 | 23.12.2014 | Korçë | Musa | Jahja | Bajram | Jahja |

Duke qenë se në kërkesë/praktikat e mësipërme, njoftimi i kërkuesit nuk është i mundur ose vendbanimi i kërkuesit nuk është i njohur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të dispozitave të Kodit të Proçedurave Administrative, ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit"*, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 222, datë 23.03.2016 *"Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës"* e ndryshuar, bën njoftimin me shpallje në selinë e ATP-së, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi, si dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin, për të njoftuar subjektet kërkues për procedimin administrativ të hapur dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

**Subjektet kërkues për procedimin administrativ të sipërcituar duhet të paraqiten në Drejtorinë e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, në adresën:** ***Rruga "Muhamet Gjollesha", nr. 54, Tiranë.***

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Valdrin PJETRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË - AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE - TIRANË